



Për: Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, dr Sali Berisha
Nga: Kryetari i Aleancës Kosova e Re, z. Behgjet Pacolli
Subjekti: Telegram ngushëllimi për tragjedinë në Gërdec

Prishtinë, 17 Mars 2008

Telegram Ngushëllimi

I nderuari z. kryeministër,

Me shqetësim të madh, morëm lajmin e hidhur për tragjedinë në Gërdec, si pasojë e së cilës humbën jetën qytetarë të pafajshëm dhe qindra tjerë u plagosën.

Kjo tragjedi u përjetua rëndë nga i gjithë populli i Kosovës, i cili e ndjenë dhimbjen së bashku me ju, për këtë tragjedi gjithë kombëtare.

Shpërthimi në Gërdec ishte një tronditje për të gjithë popullin shqiptarë, prandaj do të jemi bashkë gjithmonë, për të përballuar situata të tilla, dhe për të qenë krah njëri tjetrit, në momente të vështira.

I nderuari, z. Kryeministër, dr. Sali Berisha, më lejoni të iu shpreh ngushëllimet më të sinqerta Juve, familjeve të viktimave dhe gjithë popullit shqiptar. Urojmë nga zemra që të lënduarit të shërohen sa më shpejt dhe ti kthehen jetës normale nëpër shtëpitë e tyre.

Aleanca Kosova e Re edhe njëherë shpreh solidaritetin me popullin shqiptar në këto momente të rënda për gjithë Kombin Tonë.

Me nderime,

*Behgjet Pacolli,
Kryetar i Aleancës Kosova e Re*